REFERATE E KUMTESA

LUAN TETAJ

KUVENDET NDËRBALLKANIKË TË KUÇIT (1614)

Krahina e Kuçit në shekujt e mëhershëm i përkiste trevave shqiptare, sot rajon në pjesën lindore në Malin e Zi, me fisin e saj historik. Krahina e Kuçit shtrihet nga lumi Cijevna dhe kufiri në mes të Shqipërisë dhe Malit të Zi në lindje, deri në lumin Moraçë dhe degën e tij Malla Rijeka në perëndim, pastaj prej majave të larta të malit Koma në veri deri në rrafshinën e Zetës rreth Podgoricës në jug.

Kuçi përmendet në vitin 1455 në marrëveshjen (e nënshkruar në Manastirin e Shën Nikollës në Vraninj) dhe Mbretit të Zetës Stefan Crnojeviç, përfaqësuesve të fshatrave të Zetës me autoritetet – pushtetin venecian.[1]Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, jep të dhëna se nahija e Kuçit varej nga Sanxhakut i Shkodrës që kishte tetë fshatra dhe 85 shtëpi. Në vitin 1582/1583 në defterin (regjistër i taksave osmane), nahija e Kuçit kishte 13 fshatra të cilat i përkisnin sanxhakut të Shkodrës.[23] Relacioni i Mariano Bolicës në përshkrimin e sanxhakut të Shkodrës më 1614, thotë se nahija e Kuçit ishte shqiptare që i përkiste ritit roman.[4] Në burimet historike, së pari përmendet mbiemri Kuç, dhe pastaj në burimet veneciane përmendet qysh në vitin 1614, fshati Kuçi dhe 14 familje në rrethin e Shkodrës.[5] Më vonë përhapet edhe emri i fisit dhe rajoni i tyre fisnor, kështu që në kuadër të fisit kanë hyrë banorë me prejardhje të ndryshme. Nga përbërja e tyre etnike sot kuçasit janë fis i përzier, i përbërë prej shqiptarëve dhe serbëve. Fisi i Kuçit është i përzier edhe në pikëpamje fetare sepse anëtarët e këtij fisi mbajnë tri besime:

---

[1] *Istorijski Leksikon Crne Gore,* Libri 4, VJESTI, Podgorica: 2006, f. 819.

[2] Vasić Milan, *Etnički odnosi u jugoslovensko-albanskom graničnom području prema popisnom defteru sandžaka Skadar* 1582/1583, 1991, 7. 27.

[3] Selami Pulaha, *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1974, f. 386.

[4] Robert Elsie, "Early Albania: A Reader of Historical Texts, 11th-17th Centuries", *Harrossowitz Verlag – Wiesbaden,* 2003, f. 155.

[5] *Istorijski Leksikon Crne Gore…*, f. 819.

katolik, ortodoks dhe mysliman. Pjesën më të madhe e përbëjnë serbët ortodoksë banues në pjesën më të madhe të krahinës, shqiptarët katolikë janë të vendosur në pjesën më të madhe në zonën e mbyllur pranë lumit Cijevna, Zatriebaç dhe në pjesën jugore të fisit. Në këtë zonë ka edhe myslimanë që janë të vendosur në qendra të ndryshme banimi.[6] Krahina e Kuçit paraqet një shembull të vetëm bashkimi të dy popujve dhe tri besimeve në një fis.

Kuçi është fis i vjetër, më këtë emër përmendet edhe në dokumentet serbe të shek. XIV, në një «Krisobulë», shkresë zyrtare për dhurata e privilegje të ndryshme, të mbretit Stefan Deçanski në vitin 1330, me të cilin i fali Kishës së Deçanit shumë katunde. Kur bëhet fjalë për disa katunde shqiptare, në këtë dokument përmendet edhe "Pjetër Kuçi me vëllezër".[7]

Në shek. XV dhe XVI në krye të nahijes së Kuçit gjendej një vojvodë osman. Sipas Marian Bolicës këta vojvodë gjykonin dhe administronin kuçasit ashtu si në nahijet e tjera të Bërdos dhe të malësorëve, duke e blerë në krye të çdo tre muajve këtë pozitë prej sanxhakbeut të Shkodrës. Garnizoni i kalasë së Medunit kishte për detyrë të kontrollonte Kuçin. Përveç vojvodës osman më 1614 Bolica përmend edhe dy kryetarë kryesorë në Kuç, Nikë Raiçevin dhe Lale Drekali.[*] Në krye të fshatrave apo grupeve të fshatrave gjenden kryetarët vendas që quhen princa. Për ta është ruajtur edhe gojëdhëna e popullit, po ashtu

---

[6] *Arkivi i Institutit të Historisë,* Tiranë (më tej: *AIH*), Fondi, A-II-36, Vaso Qubrilloviç, "Formimi i fisit të Kuçit".

[7] Mark Krasniqi, *Gjurmë e gjurmime, studime etnografike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 1979, f. 277; Miloš S. Milojevič, *Dečanske hrisoovulje, Glasnik Srpskog Učenog Društva,* knjiga VII, Belgrade: 1880, f. 55.

[*] *AIH*, A-III-222, "Dokumente mbi Kosovën nga relatorë të huaj (shek. XVI-XVII)". *Lale Drekali ishte prijës i fisit nga nahija e Kuçit. Babai i tij Marko Miljanov kishte dy djem, Nikollën dhe Lalen. Ai dhe familja e tij i përkisnin fesë katolike, por sipas një marrëveshje me Ruvimom II Boljevičem (1593-1636), Mitropolit të Cetinës ai u konvertua nga feja katolike në fenë ortodokse. Familja e tij dhe një pjesë e fisit që i përfaqësonte e ndoqën shembullin e tij. Ai mori pjesë në dy këshillat e patriarkut serb Jovan Kantil II, që planifikon për të luftuar kundër Perandorisë Osmane. Sipas relacioneve të Marian Bolica 1614, Lale Drekali dhe Niko Raičkov mbajnë 490 shtëpi të Chuzzi Albanesi (Kuçi shqiptarë, një fshat që pjesa dërmuese i takonin fesë katolike), me 1500 ushtarë, luftëtarë shumë të guximshëm. Ata ishin ndër 11 fshatra malore që luftonin në mënyrë aktive Perandorinë Osmane. Ai u martua me motrën e vojvodë Bratonožiči, Pejo Stanojev me të cilën pati katër djem: Vujoša, Ilika, Čeja dhe Mija.*

flitet edhe në burimet historike në shek. XVII. Në fillim të shek. XVII në burimet veneciane shfaqen vojvodët prej vëllezërve Drekaloviq si të parët e fisit të Kuçit.[8] Fshatrat në nahijen e Kuçit vetadministroheshin nën udhëheqjen e kryetarit vendas. Marrëdhëniet me autoritetet osmane siguroheshin përmes nahijes ku paguheshin tatime dhe rregulloheshin çështjet e kullotave në raport me fiset fqinje. Të gjitha problemet zgjidheshin në kuadrin e nahijes dhe dërgonin në bashkimin e popullit të krahinës së Kuçit.

Krahina e Kuçit ishte njësi vetadministrative ku organet osmane të pushtetit vepronin drejtpërsëdrejti me anën e aparatit administrativ lokal në principata dhe fshatra. Ky aparat vetadministrativ i vendit përpiqej të bashkohej kundrejt autoriteteve osmane, atëherë kur akoma nuk ekzistonte një fuqi e vetme fisnore e formuar që do t'i imponoonte udhëheqjen tërë bashkësisë siç ndodhi në Kuç në shek. XV dhe XVI. Për këtë qëllim organizoheshin mbledhje të krerëve të krejt nahijes, kuvende me karakter krahinor lokal dhëndër ballkanik në të cilat zgjidheshin çështjet që kishin rëndësi për krahinën dhe më gjerë.

Në vitet e fundit të shek. XVI filluan lëvizjet çlirimtare për dëbimin e Perandorisë Osmane. Një nga format e organizimit dhe e bashkëpunimit ndërkrahinor padyshim ishte edhe mbajtja e Kuvendeve. Shqiptarët ishin katalizatorë për lëvizjet e mëdha ballkanike, sepse edhe rrethanat politike ishin më të favorshme. Shtetet evropiane përgatiteshin t'u ndalnin hovin pushtimeve osmane në Ballkan. Duhej shfrytëzuar situata e zhvillimit të Luftës Austro-Turke 1593-1606.[9] Kuvendet shqiptare dhe ndërballkanike nuk kishin të bëjnë me vështrimin e ngushtë të organizimit fisnor, por kishin karakter më të gjerë midis krerëve të krahinave të ndryshme që bashkoheshin në momente të vështira për të luftuar në rast të një rreziku të madh.

Kuvendet gjatë asaj kohe morën një vështrim ndërfisnor dhe përfaqësonin fazën e parë të një bashkimi politik në mes zonave, të cilat do të bashkoheshin dhe përforcoheshin në rast të sukseseve të tyre. Bashkimi i tyre do ishte në fuqi për sa kohë do të merreshin vendime, shtroheshin projekte dhe pritej koha e volitshme për të filluar luftën.

---

[8] *AIH*, Fondi, A-II-36, "Formimi i fisit të Kuçit...".

[9] Injac Zamputi, "Rëndësia ndërkombëtare e Kuvendeve shqiptare në kalimin prej shekullit XVI-XVII", në *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, Seria e Shkencave Shoqërore, Numri jubilar me rastin e 50-vjetorit të Shpalljes se Pavarësisë, Viti XVI, 4, Tiranë, 1962. f. 250.

Kishte edhe raste më të avancuara të bashkimit ndërkrahinor, kur kuvendi i përbashkët caktonte kryetarin e përhershëm, i cili në rast nevoje lidhte i pari marrëveshje me krerët e tjerë kryesorë ose me përfaqësuesit e princave të Evropës. Lëvizjet e armatosura dhe bashkimi i kuvendeve fisnore, ngritën moralin dhe vetëdijen njerëzore se vetëm me bashkimin e vendeve të Ballkanit mund të realizohen projektet e shtruara në kuvendet ndërballkanike për të filluar luftën e përbashkët për largimin e osmanëve nga trevat e Ballkanit.

Deri në vitin 1614 një numër i mirë i ndërmjetësuesve punuan në emër të popullsisë shqiptare dhe serbë pranë oborreve princërore. Puna e tyre ishte veçuar sa që mund të dallohen kryesisht tri grupe: si përfaqësues të grupit të parë kanë qenë: Nikolla Drashoviq, Frati Andrea Poljiçanin, Atansa Gërgiçeviq, kalorësi Bërtuçeviq dhe abati Çedolini nipi i peshkopit të hershëm të çullës Pjetër Çedolini. Aty morën pjesë edhe ndërmjetësit shumë aktiv Domenik Adrijasheviq dhe Aleksandër Komulloviq. Ata, madje, me punën e tyre të mëparshme kishin krijuar lidhje të forta me përfaqësuesit e grupeve të tjera. Ky grup ka tentuar të nxiste kryengritje në rrethin e Klishit ose befasisht të sulmonin këtë qytet, me planin që pas marrjes ta përdornin si bazë për punën e mëtejme, kurse më vonë me ndihmën e papës dhe sundimtarëve perëndimorë të çlirojnë të krishterët nga sundimi osman. Grupin e dytë e përbënin me shumicë shqiptarët. Përfaqësuesit kryesorë ishin: argjipeshkvi i Tivarit Marin Bici, nipi i tij abati Aleksandër Nikolini nga Peshkoviqi i vetëquajturi i Maqedonisë, italiani Konti Turiani dhe ipeshkvi Skoroveo Stefanski. Orientimi i tyre ishte bërja për vete e Papës dhe sundimtarëve perëndimorë të cilët duke u mbështetur në kryengritjet e shqiptarëve do të dërgonin ushtrinë e tyre në drejtim të Ulqinit, Shkodrës dhe Vlorës. Mandej kjo ushtri me ndihmën e të krishterëve të tjerë në Gadishullin Ballkanik të shkatërronte ushtrinë osmane dhe të themelonte një shtet të ri të krishterë. Grupi i tretë ishte më i madhi dhe përbëhej nga ata që punonin si ndërmjetës të patriarkut të Pejës Jovanit, të dukës së Onogoshit, Gërashanit dhe krerëve të tjerë. Në vitet e para të shek. XVII, ky grup ishte më i madhi në numër, por u zvogëlua kaq shumë sa që në vitin 1614 shquheshin kryesisht dy personalitete, shqiptari kapedan Gjon Renësi dhe aventurieri Sulltan Jahja.[10]

[10] *AIH*, P–44, "Mbledhje e marrëveshje të krerëve serbë në Kuç në vitin 1614 për kryengritjen kundër turqve".

Kapedan Gjon Renësi duke lëvizur nëpër Itali nga një anë në tjetrën, si njeri i shkathët krijoi mjaft lidhje. Njëri prej tyre ishte Gjakomo Pertuzi, teolog, doktor, jurist dhe producent i cili kishte lidhje me botën e të diturve dhe fisnikëve. Pertuzi në marsin e vitit 1614 vizitoi Milanon, ku takon Gjon Renësin dhe i thotë që duke ditur se ai kishte lidhje shumë të mira me shumë fisnik të elitës dhe se ata e prisnin me dëshirë që të kuptonin prej tij se kush mund të shpinte fshehurazi tek Duka i Parmës me të cilin mendonte të merrej vesh mbi një çështje shumë të rëndësishme dhe premtoi se Pertuzit mik do t'ia besonte të gjitha. Ai lidhur me këtë iu përgjigj se asgjë nuk ishte më e lehtë, sepse "Dukën e Parmës e kishte mik të mirë, miku i tij Duka i Polit". Pas kësaj përgjigjeje Renësi i tregoi me mirëbesim se si mendonte ai që, me Dukën e Parmës të merrej vesh mbi pushtimin e Shqipërisë, gjë për të cilën në këtë rast do të kishte në dorë popullin e kësaj krahine me krerët e të cilit kishte marrëdhënie të mira. Kjo i pëlqente Pertuzos dha pa ngurrim së bashku me Renësin shkojnë në Parmë, menjëherë pas Pashkëve. Kur arritën në Parmë, Pertuzo menjëherë u kthye me Dukën e Polit. Në bisedë Renësi e njofton për qëllimin e tij, i cili pas kësaj fshehurazi një natë dërgoi Renësin dhe Pertuzon te Duka për bisedime. Më vonë takimet me Dukën u shpeshtuan dhe bisedimet zgjatën plot dy muaj. Rezultati i këtyre përpjekjeve ishte që Duka mori përsipër rolin e mëparshëm të Dukës së Savojës dhe atij të Montavës që me ushtrinë e tij i përkrahur edhe nga spanjollët të futeshin në Shqipëri dhe të ndihmonin në kryengritjen e fiseve serbe e shqiptare, gjë për të cilën ata do ta emëronin për mbret.[11] Por, meqenëse për realizimin e kësaj detyre nevojitej të siguroheshin mjete dhe të përgatitej populli i shtypur nga osmanët, këtë e mori përsipër Duka i Parmës duke llogaritur se tjetrën do ta realizonte me anën e Renësit dhe duke mos dashur ta shtyjë i dha këtij letra për krerët dhe para për rrugë.

Lista e pjesëmarrësve që morën pjesë në Kuvendin e Kuçit korrespondon me të dy datat. Lista ka ndonjë ndryshim qoftë në grafi, qoftë në renditje, po pjesëmarrësit janë të njëjtë. Vetëm dy emra shkëmbejnë vendet në renditje.[12]Madje, vetë Gjon Renësi bën fjalë për dy

[11] *Po aty.*

[12] *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë,* vëll. III (1603-1621), përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, dok (188): "1614 Korrik 15 – tetor – Lista emërore e 44 krerëve shqiptarë dhe kombësish të tjera ballkanike, të mbledhura në Kuvendin e

kuvende. Ai në kuvendin e parë kishte treguar për premtimet dhe kërkesat e Dukës së Parmës. Pasi krerët kishin analizuar fjalët e Kapedan Gjon Renësit e ftuan që të hynte brenda në Kuvend.[13] Materialet dokumentare që posedojmë japin të dhëna se Kuvendi i Kuçit është mbajtur më 14 korrik dhe më 8 shtator të vitit 1614. Në vazhdimësi po paraqesim tekstin e relacionit mbi përbetimin e bërë në Kuvendin e Kuçit të korrikut 1614:

"Shumë i Përndritshmi princ,

Në qershor të vitin 1614 arrita në Mal të Zi dhe u strehova në shtëpinë e zotit Kont Vojo (Vujo) i ati i kontit Mark, me të cilin bisedova për traktatin e bërë me lartësinë Tuaj shumë të Përndritshme, prej nga u dërgua menjëherë një njeri posaçërisht tek konti Vojo (Vujo) nga Risani dhe tek konti Gjon i Zupës së Epër, që të vinte menjëherë për të biseduar gojë me gojë me mua dhe zotërinjtë e lartpërmendur kontit babë e bir. Natën tjetër arritën dhe të gjithë së bashku mbasi bëmë një bisedë të mirë e të gjatë, vendosëm të dërgojmë për të thirrur të nënshkruarit zotërinjtë të gjithë të përbetimit: Konti Lala Drekali i Kuçit dhe Gjin Gjergjin nga Dukagjini në Shqipërinë e Epërme dhe kontët e Vershevos, që të lajmëronin të gjithë të përbetuarit të mbretërive të afërme që të gjithë më 14 korrik të vitit 1614 të vinë në Kuç te konti i lartpërmendur për t'i paraqitur dhe për t'i pleqëruar të gjithë ata që kishin sjellë me vete rishtas rreth marrëveshjeve dhe qëllimeve të përbetimit tonë. Të dërgonin vulat e tyre sekrete me betimin se gjithçka do të përfundojë me ratifikimin e asamblesë".[14]

Sipas dokumentit më 14 korrik të vitit 1614 në Kuvendin e Kuçit u mblodhën të përbetuarit 25 (njëzetepesë) krerë nga më kryesorët, të tjerët duke mos mundur të vinin për shkak të vështirësive të ndryshme, dërguan sekretarët e tyre me vula vetjake dhe betime. Gjithsej bëheshin 19 (nëntëmbëdhjetë) veta. Në Kuç u mbajt një Kuvend me përmasa të mëdha ndërballkanike, ku u parashtrua çdo gjë që ishte sugjeruar nga Lartësia shumë e Përndritshme, dhe si rrjedhojë, Gjon Renësi u ftua të hynte në Kuvend duke i kërkuar: "Kthehuni te Zotni Duka dhe në emrin tonë paraqitni fillimisht nderime që ia dërgojmë për mbretin tonë dhe

---

Kuçit, qendër kryengritëse në malet shqiptare të Veriut. Hollësira mbi zhvillimin e punimeve, mbi projektin për çlirim etj., që nxirën nga paraqitja e kapedanit shqiptar Gjon Renes, i dërguari i veçantë i Kuvendit pranë dukës të Parmës" f. 299.

[13] Petrika Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit (1506-1750),* Fusha politike II, Tiranë: Toena, 2003, f. 202.

[14] *AIH*, P-44, "Mbledhje e marrëveshje e krerëve serbë në Kuç ...".

Zot, por, i lutemi që të ketë mirësinë të mos bëjë ashtu siç kanë bërë princa të tjerë, domethënë Papa Klementi i VIII, Perandor Rudolfi dhe me në fund zotërinjtë Duka të Savojës e të Mantovës. Ata me premtimet e tyre bënë të ngrihemi në kryengritje me shpenzime tepër të mëdha, duke na munguar ndihma dhe përkrahja që na kishin premtuar, e kemi pësuar me jetë, me nder dhe me mall. Për shkak të venedikasve, të cilët për t'u treguar kaq shumë miq të armikut të përbashkët dhe çdo herë e kanë paralajmëruar, të dëshpëruar duke pritur gjatë ndihmën e Princave katolikë. Kishim menduar për kthimin tuaj përpara se të sillnit vendimin serioz për t'u dërguar mbreti i Ingliterës (Anglisë) dhe të Kontit Mauricio. Me qëllim që të bëni një lidhje me të gjithë princat Protestantë të Alemanjës (Gjermanisë) dhe që në mes tyre të zgjidhnin një udhëheqës që do të ishte i mjaftueshëm për të mbretëruar këta popuj tanë dhe për të na mbrojtur me ndihmën e armatës dhe të ushtarëve".[15]

"Por, dashtë perëndia që ky princ të jetë ashtu siç premtonte vet, me ndihmën e Mbretit të Madh të Spanjës, do të kapërcejë të gjitha vështirësitë dhe do të na çlirojë nga tirania e armiqve kaq mizorë. Jemi të kënaqur ta pranojmë atë për mbret e zot tonin dhe do t'ju jepni në duar këto letra, duke ju përgjëruar me emrin tonë që të na dërgojë një anije të armatosur shumë mirë, që kur të ktheheni ju të mund t'i dërgojmë lartësisë së tij shumë të Përndritshëm ambasadorit tonë të cilët do t'i zgjedhim dhe do t'i nisim menjëherë sa të kthehet shumë i Përndritshmi patriarku ynë që ndodhet në Kostandinopojë për të përgatitur tributin e dy vjetëve që përfshijnë katër mijë sulltanije (njësi parash).

Lidhur me sasinë e fortesave dhe lumenjve që Lartësia e tij dëshiron të dijë, janë vënë në listë si dhe sasia e njerëzve që ne na mjaftojnë për t'u ngritur rreth 200.000 apo 300.000 njerëz të armatosur dhe të gatshëm e të sigurt për ti shërbyer lirisë sonë dhe lavdisë së Mbretit tonë të ardhshëm. Së fundi, ambasadorët tonë që do t'i dërgojmë mbi Anijet e Tij: do t'ju japin sqarime për të gjitha ngjarjet e nevojshme për sadisfaksionin e Lartësisë së Tij shumë të Përndritshëm dhe për ndërmarrjen tonë në realitetet kaq të rëndësishme. Ndërkaq i thoni se me kthimin tuaj këtu me

[15] *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë ...,* vëll. III, dok. (188): "1614 Korrik 15-tetor-Lista emërore e 44 krerëve shqiptarë dhe kombësish të tjera ballkanike, të mbledhura në Kuvendin e Kuçit, qendër kryengritëse në malet shqiptare të Veriut. Hollësira mbi zhvillimin e punimeve, mbi projektin për çlirim etj., që nxirën nga paraqitja e kapedanit shqiptar Gjon Renes, i dërguari i veçantë i Kuvendit pranë dukës të Parmës" f. 292.

Anije do të ishte mirë që ai të dërgonte një inxhinier, që t'i shikonte të gjitha skelat dhe pozicionet ku do të duhej të ndërtohen fortesat për të sistemuar më mirë vendin, dhe do të ishte edhe më mirë që Lartësia e Tij shumë e Përndritshme të siguronte atë sasi të madhe armësh që do të jetë e mundur për këmbësorin dhe kalorësin, dhe sa më shumë topa që të këtë për t'i përdorur në viset bregdetare.[16] Sigurisht, shifrat janë të ekzagjeruara, sepse po të kemi parasysh gjatë asaj kohe e gjithë Perandoria Osmane nuk kishte me shumë se 250.000 ushtarë, duke përfshirë edhe hapësirën detare dhe tokësore.[17] Dhe këtu qe fundi i relacionit të Gjon Renësit dhe rifilloi të thotë:

"Shumë i Përndritshëm Princ,

Me këtë që thashë isha ngarkuar nga ata zotërinj, tani nga ana ime them që Lartësia e Juaj e Përndritshme të ju njoftoi se sa nderë e realitet ndava me princat krerët dhe zotërinjtë. Them se mua më mjafton shpirti për të vepruar vëllezërish me ata, ambasadorët që do të dërgohen të cilët vet do të ofrojnë si pengje sigurie bijtë e tyre dhe vëllazëritë e të gjithë zotërinjve të përbetuar. Atëherë ju lutem të pritni me kënaqësi si diçka që vjen t'ju sjellë sadisfaksionin më të madh dhe punën time, siç është një marrëveshje e tillë kaq e zakonshme dhe kaq e rëndësishme, edhe pse unë jam i sigurt se ata zotërinj nuk kanë për t'iu shmangur kurrë fjalës së dhënë dhe betimit të bërë. Qoftë për paprekshmërinë dhe forcën e shpirtit që mbretëron në gjokset e tyre, qoftë për dëshirën e zjarrtë që kanë për t'u çliruar nga zgjedha e rëndë dhe e padurueshme e robërisë. Por, të gjitha këto le ta marrë Lartësia Juaj shumë e Përndritshme si zellin tim me të mirë dhe si shpengim për mua.

Sa i përket anijes ajo është e nevojshme dhe le të jetë e armatosur mirë dhe e pajisur me qëllim që po të ndeshet me galerat e venedikasve ose me anijet e tjera të paktën të mund të mbrohej prej tyre dhe Lartësia e Juaj shumë e Përndritshme. Të shohim se sa janë të dëshiruar ata zotërinj për ta përfunduar këtë marrëveshje, premtojnë se do ta mbrojmë anijen me të gjitha shpenzimet, domethënë se do të paguajnë marinarët dhe do ta mbajnë deri sa anija do të jetë në shërbim për t'i çuar atje dhe për t'i kthyer ambasadorët në vend dhe për t'i sjellë pengjet. Në rast se luftërat në Itali do të shpërthej do mund t'i shërbejë Lartësisë suaj shumë të Përndritshme për të transportuar kuaj e ushtarë nga Shqipëria dhe

[16] *AIH*, P–44, "Mbledhje e marrëveshje të krerëve serbë në Kuç ...".
[17] Petrika Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit* ..., f. 204.

Provinca të tjera për korrespodencën e tyre e atyre zotërinjve që për çdo udhëtim do t'u takonte të transportonin gjashtëdhjetë deri në shtatëdhjetë kuaj për çdo herë, udhëtime të tilla nga Ankona në Shqipëri bëhen shpejtë.[18]Do të mund të shërbente anasjelltas për mallra të ndryshme ato që do t'i pëlqente Lartësisë suaj shumë e Përndritshme".

Emrat, mbiemrat dhe vendi i të gjithë zotërinjve të Përbetuar në Kuvendin e Kuçit, në fillim gjashtë ato që mbajnë funksione dhe autoritetin për të thirrur të tjerët në kuvend.

Në krye: Gradan (Gardan), Vojvoda prej Novogostos; Konti Lala Drekali prej Kuçit; Konti Vojo prej Risanit; Konti Vojo prej Malit tëZi; Gjec Bardhi prej Mirdite; Protoppi Ivanoviqi; Konti Nikolla, prej Piprit; Konti Selak (Shllak?) prej Grijet (?); Vojvoda Raic i Palabardhi (Bjelopavliqi); Rode Vojvoda, prej Planit (Plave?); Konti Petar, prej Plushve (?); Konti Cepivo, prej Ljeshkopoljes (Fusha e Ljeshkës); Konti Drahigo (Dracigo) Geleci (Gezezi?); Konti Merzita (Menzita Mireta?) Sernica (Cernica); Konti Nikolla Mengulla (?) (Negushi); Gjin Gjergji Dukagjini; Konti Vule Dubigine (Dubinje?); Konti Radosava Bronci (Bonci?); Konti Mark, prej Malit të Zi; Konti Gjon nga Zhupa e Epërm; Vojvoda Vuka (Vuka Keqi, Vuka Gjeci?) i Kelmendit; Konti Thoma nga Vershevo; Konti Pavle (?) prej Prizreni; Vojvoda Gjek Culi (?) nga Boga; Konti Milia nga Bjele (Bardha e Kuçit?). Ata që mungonin:Konti GjonPlesisi (Lleshi i Zi?); Konti Dragoi nga Rudina; Konti Mileta Rigano; Konti Gjon Mustaki; Konti Millosh Çekanji (Çekaj?); Konti Mikel (Mihal) nga Prejs; Konti Thoma i Kostas; Konti Vuisko nga Biloshit; Konti Vigo Ravan nga Grimiqi (?); Konti Vukigj (Vuk Keqi?) nga Usano; Konti Voin nga Balea (Baleza?); Konti Andrea nga Zhupa e Poshtme; Konti Mile nga Kupe (Prokupi?); Konti Thoma nga Podgorica (?); Konti Stepan Raçeçi; Konti Vule nga Zeta (Genta); Vukosha nga Trepsha (?); Konti Andrea nga Plesiuvci; Popo Voin Rasanina (Zaravina?).[19]

---

[18] *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë ...,* vëll. III, dok. (188): "1614 Korrik 15 – tetor – Lista emërore e 44 krerëve shqiptarë dhe kombësish të tjera ballkanike, të mbledhura në Kuvendin e Kuçit, qendër kryengritëse në Malet Shqiptare të Veriut. Hollësira mbi zhvillimin e punimeve, mbi projektin për çlirim etj., që nxirën nga paraqitja e kapedanit shqiptar Gjon Renes, i dërguari i veçantë i Kuvendit pranë dukës të Parmës" f. 295.

[19] Luigi M. Ugolini, *Pagine di Storia Veneta ai tempi di Scanderbeg e dei suoi successor* (con due documenti), dok. (2), f. 34; *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës*

Nga 44 krerët që morën pjesë në Kuvendin e Kuçit, gjashtë të parët ishin krerë kryesorë që kishin autoritet të thërrisnin në kuvend të tjerët. Më poshtë, janë krerët pjesëmarrës në kuvend gjithsej 25 krerë kryesorë dhe 19 të fundit edhe pse kishin të drejtë pjesëmarrje, nuk kishin pasur mundësinë të ishin të pranishëm, por kishin dërguar sekretaret e tyre me vula personale sekrete.Krerët që morën pjesë në kuvend përfaqësonin Kuçin, Rizanon, Malin e Zi, Mirditën, Pipërin, Palabardhin, Plavën, Plushiven, Leshkopoljen (Fusha e Ljeshkës), Gëzezin, Cërnicën, Negushin, Dukagjinin, Dubinjën, Boncin, Zhupën e Epërme, Kelmendin, Vershevon, Prizrenin, Bogën, Bardhën e Kuçit. Sekretarët përfaqësonin kontët që nuk kishin pasur mundësi të vinin nga krahinat: Lleshi i Zi, (Mirdita), Rudina, Rigano, Prejs, Biloshi, Griniqi, Usano, Balëza, Zupa e Poshtme, Kupe (Prokupi), Podgorica, Zeta, Trepsha, Plesiuvci dhe Zaravina etj.[20]

Relacioni mbi punën e kapedan Gjon Renësit, në mbledhjen e Kuvendit të Kuçit në vitin 1614, paraqitur Dukës së Parmës në vjeshtën e po atij viti është ruajtur në raportin e dyfishtë të agjentit venedikas Marmilionit paraqitur Këshillit të të Dhjetëve në Comunicate del Cana dei X dhe në Proveditori sopraintendenti alla Camera dei Confini: Dalmazia, Levante, Uscochi, Busta 4 (Komunikata të Këshillit te të dhjetëve dhe i Proveditorit mbikëqyrës drejtuar Dhomës së Kufijve, Dalmaci, Levant, Uskak Zari). Raporti i Gjon Renësit është futur në atë të Marmilionit, nga i cili disa pjesë janë botuar. Është me interes edhe vetë fillimi i tij që shërben si për relacionin – raportin e Renësit ku thuhej: *"L'anno del 1614 Capito qua messo mandato apposto dalli sig. Conginenti della Renio d'Albania di Servia e il Capitano Giovanni Renes al Sa-mo Sig-re Duca di Parma, con il quale tutte lungamente l'intenzione di quoi sig-ri Conginati. Onde Speditori da quell'Alt-a dello quale n'habbe benissimo intansione. Et percio con lettere donari at favori fice ritorno in quelle parti, dove hovendo dato difusussimo*

---

së Shqipërisë (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 846, dosja (më tej: D.) 76, Dy Kuvendet e Kuçit; *AIH*, P-44, "Mbledhja e marrëveshje e krerëve serbë në Kuç ...".

[20] Petrika Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit (1506-1750)...,* f. 203; *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë ...,* vëll. III, dok. (188): "1614 Korrik 15 – tetor – Lista emërore e 44 krerëve shqiptarë dhe kombësish të tjera ballkanike, të mbledhura në Kuvendin e Kuçit, qendër kryengritëse në Malet Shqiptare të Veriut. Hollësira mbi zhvillimin e punimeve, mbi projektin për çlirim etj., që nxirën nga paraqitja e kapedanit shqiptar Gjon Renes, i dërguari i veçantë i Kuvendit pranë dukës të Parmës", f. 296-297.

raguaglio all Assamblea ch fu il 25 di Giugno (duhet 14 luglio) dell Anno sudetto ha quale Assamblea havendo in teso, che il Sig-re Duca Volsntieri hovea abraciata il negativ torno a spedire indietro il sudetto Capitano Giovanni, il quale giunse qua del mese di ottobre et presentatasi inanzi a qull'Alt – dhe di buon oochio ha vidde foce la segmente relatione". "Në vitin 1614 u paraqit këtu i dërguari posaçërisht nga zotërinjtë e Përbetuar të Mbretërisë se Shqipërisë dhe Serbisë, kapedan Gjon Renësi, për zotërinë shumë të Përndritshëm Dukës së Parmës, me të cilin bisedoi gjerë e gjatë për qëllimet e atyre zotërinjve të Përbetuar. I dërguar atje nga ajo Lartësi me qëllim më të mirë. Prandaj me letra të holla e favore u kthye në ato anë, ku duke i pa dhënë shpjegim të gjera Kuvendit që u mbajt me 14 korrik të vitit të lartpërmendur e cila Asamble duke pas kujtuar se zoti Duka me gjithë dëshirën e kishte përfaqësuar këtë marrëveshje, e nisi përsëri nga kishe ardhur të sipërpërmendurin kapedan Gjoni, i cili arriti këtu në Parma në muajin e tetorit dhe pasi u paraqit para asaj Lartësie i cili pa me sy të mirë, e bëri relacionin që vijon".[21]

Me përfundimin e marrëveshjes në Kuvendin e Kuçit më 14 korrik të vitit 1614, mbas se cilës Gjon Renësi u largua nga Kuçi, shkoi në Bregdet dhe pastaj kaloi në Itali, për t'ia paraqitur Dukës së Parmës raportin dhe t'i dorëzonte letrat nga Kuvendi i krerëve në Kuç. Kështu thuhej në raport, por, e vërteta është që Renësi ka arritur në Itali nga fundi i tetorit të atij viti. Sapo kishte arritur e njoftoi gojarisht Dukën për gjithçka që e kishin porositur nga Kuvendi i Kuçit. Por, Duka deshi që të gjitha këto të paraqiteshin në një raport me shkrim. Prandaj Renësi u tërhoq në një dhomë të veçantë në oborrin e Dukës së bashku më Giacomo Pertuzio, dhe meqenëse për hartimin e raportit i duhej edhe një njeri me penë të fortë, Pertuzio thirri mikun e tij Marmiljonin të cilit Renësi i tregoi udhëtimin e tij dhe gjithçka duhej parashtruar në raport, ky e formuloi menjëherë. Marmilioni mbasi hartoi konceptin së pari kopjoi për vete një kopje e fshehu dhe kur u largua nga pallati i Dukës e mori me vete. Ky dokument ishte me interes dhe shërbeu si argumenti më i mirë i punës së Renësit dhe rolin që kishte filluar të luante që nga viti 1606, por kurrë nuk e realizoi si atë të vitit 1614.[22]

---

[21] *AIH*, P–44, "Mbledhje e marrëveshje e krerëve serbë në Kuç ...".
[22] *Po aty.*

Në këtë raport krahas të dhënave ka edhe diçka për misionin e Renësit të Duka. Mbasi njoftoi për punën që kishte bërë në Kuç dhe ç 'porosi kishte marrë nga krerët, ky i përmendi Dukës se si mund të punohej me përfaqësuesit që mendojnë t'i dërgojnë krerët të cilët në shenjë garancie sa më të madhe dëshirojnë që si pengje të japin bijtë e vëllezërit e tyre, prandaj iu lut Dukës që ata për hir të një suksesi sa më të madh të çështjes së filluar t'i presin me vullnet të mirë, sepse ishte i bindur se krerët nuk do të shkelnin fjalën e dhënë, meqenëse kishin etje të jashtëzakonshme të çliroheshin nga zgjedha e rëndë dhe e padurueshme e sunduesit osman.

Me anijen me të cilën do të transportoheshin për në Itali përfaqësuesit e tyre i thanë Dukës se duhet të jetë i fortë dhe i armatosur mirë që të mund të mbrohej në rast se do të ndeshej me galerat venedikase ose ndonjë flotë tjetër. Për ta bindur Dukën krerët mendonin t'i përvisheshin punës. Renësi shtoi se si i kanë premtuar që mbasi të këtë paguar Duka anijentë merrnin përsipër për t'i paguar vetë detarët e saj për gjithë kohën sa do të jetë e nevojshme. Sipas mendimit të tij në atë anije do të transportoheshin përfaqësuesit për në Itali dhe do të ktheheshin përsëri dhe pastaj të merreshin pengjet. Në rast se do të shpërthente lufta në Itali, Duka mund t'i përdorteata për transportin e shqiptarëve dhe kuajve nga Shqipëria dhe krahinat e tjera, gjë në të cilën krerët e lartpërmendur do të ishinnë dispozicion të tij. Dhe në fund anijet mund shërbenin edhe për transportin e mallrave, kështu që në asnjë rast nuk do të vinte ndonjë dëm prej tij. Por krahas gjitha këtyre në raport të Renësit është bashkangjitur edhe lista e emrave të krerëve që ishin prezent në Kuvendin e Kuçit dhe atyre të tjerëve që me anën e të besuarve të tyre dërguan vulat e tyre me betim.[23]

Sipas fjalëve të mikut të Pertuzosë Marmilioni, i cili në oborrin e Dukës së Parmës me diktimin e Renësit e përpiloi raportin mbi Kuvendin e Kuçit më 4 korrik të vitit 1614, dhe që tërë punën e Renësit pranë Dukës së Parmës ia sqaroi Sinjorisë së Venedikut, kur Renësi në tetor të vitit 1614 paraqiti raportin, Duka i Parmës deshi të bindej për gjithçka që e njoftoi ky me shkrim dhe me gojë. Prandaj vendosi që në ato vise të dërgonte të besuarin e tij, kurse kapedan Gjon Renësin ta mbante në Parmë deri sa të ktheheshin ata. Marmilioni thotë më tej, se Duka e realizoi dëshirën e vet, sepse gjeti disa njerëz të cilët i urdhëroi të shkonin

[23] *Po aty.*

në Shqipëri për t'u bindur për raportin e Renësit. Pasi vizituan ato vise, kur u kthyen u bindën për gjithçka, çka kishte thënë me gojë dhe me raportin e tij Renësi. Kishin sjellë me vete një françeskan Andrea Boshnjakun, mik i besuar i krerëve shqiptarë dhe serbë, i cili kishte për të vërtetuar vërtetësinë e raportit të Renësit.[24] Por, e keqja ishte se ky nuk dinte fare italisht, kështu që Duka nuk mund ta pyeste veçmas. Prandaj, Duka e mbajti më gjatë dhe i dha rast të mësojë italishten, dhe kur e arriti këtë filloi ta pyeste dhe mori vesh se Renësi kishte thënë të vërtetën. I bindur rrugës që kishte nisur, Duka me në fund në korrik të vitit 1615 përgatiti përfaqësuesit për të çuar në Shqipëri Renësin, Andrea Boshnjaku dhe një inxhinier, për të dërguar letra dhurata dhe përshëndetje krerëve dhe prej andej të silleshin pengjet si garanci se do të punohej, siç duhej.[25]

Para nisjes Renësi tha se do të kthehej afërisht nga fundi i tetorit dhe madje nëpër Ankonë, kurse Duka duke besuar fort në këtë, me t'u nisur përfaqësia nga Parma plot entuziazëm dërgoi një përfaqësues të posaçëm tek mbreti i Spanjës për ta njoftuar mbi hapin e ndërmarrë dhe e luti për përkrahje kur do të ishte nevoja. Duka u ngroh me shpresë për suksese nga ndërmarrja e Renësit, por as rrethi i tij dhe as informatori venedikas, askush nuk mundi të vinte re se Duka kishte rënë në duart e një grupi aventurierësh.[26] Në oborrin e Dukës askush nuk mund të mendonte që Renësi nuk kishte shkuar në Shqipëri. Në vend që të shkonte në Shqipëri dhe të dërgonte porosinë e Dukës krerëve dhe të hyjë në marrëveshje, Renësi kishte shkuar në Mantovë, ku në të njëjtën kohë arriti edhe Jahjai mbas kthimit nga Gadishulli Ballkanik.

Letra e përbashkët nga Kuvendi i Kuçit 1614

Në mesin e shumë dokumenteve që disponojmë është me interes letra e përbashkët kredenciale (autorizimi që paraqet si përfaqësues të plotfuqishëm) për Gjon Renësin. Është me interes që fillimi i këtij dokumenti tregon lidhjen e veçantë me fillimin e atij dokumenti mbi mbledhjen e krerëve fetarë në Kuç në vitin 1614. Aty thuhet: *«Unë, Jovani patriark i Serbisë, Bullgarisë, Shqipërisë, Bosnjës, Hercegovinës dhe Maqedonisë, kryetar mbi të gjithë ortodoksët me të gjithë nënshkruesit vojvodë, princër dhe zotëri nga mbretëritë e lartpërmendura*

[24] *AQSH* , F. 846, D. 76, Dy Kuvendet e Kuçit.
[25] *AIH,* P–44, "Mbledhja e marrëveshjes së krerëve serbë në Kuç ...".
[26] *Po aty.*

me këtë të shkruar i japim tagër të plotë vojvodës Gjon Renëzi fisnik shqiptar, të bëjë traktativa dhe të përfundoi ujdinë me mbretin e Spanjës ose me cilindo nga sundimtaret e krishterë si t'i pëlqejë më mirë të përmenduri Renësi mbi mënyrën se si s'lirohet populli i mbretërisë të lartpërmendur i cili tani është nën dhunuesin dhe armikun e të gjithë fesë së krishterë. Këtë e bëjmë për shkak të dhunës së madhe që ushtronte mbi ne, jo vetëm në trajtën e haraçeve të mëdha që marrin osmanet prej nesh, por sepse në emër të haraçeve detyrohemi të japim fëmijët tanë të cilët ata i bastardojnë duke i kthyer nga feja e Krishtit dhe duke i edukuar në fe të Muhametit. Prandaj ne na shlyen Qielli e Zoti që për hir të shpëtimit të kaq mijëra shpirtrave që po humbin çdo ditë, të dërgojmë kapedan Gjon Renësin dhe me këtë shkresë i japim tagër të plotë që të ndërmjetësojë tek mbreti i Spanjës ose tek cilido sundimtar tjetër i krishterë për të na ndihmuar që të çlirohemi, dhe çdo gjë që i lartpërmenduri Renësi do të thotë ose do të premtojë në emrin tonë, ne do të miratojmë dhe në shenj vërtetësie kjo letër do të nënshkruhet dhe me vulat tona vetjake do të vërtetohet sipas zakonit që sundon tek ne».[27]

Projektet për çlirimin e Ballkanit - dalë nga Kuvendi i Dytë i Kuçit (8 shtator 1614)

Në historinë e popujve të Ballkanit në gjysmën e parë të shek. XVII, numërohen shumë projekte, përpjekje dhe kryengritje të pasuksesshme të krishterëve në Gadishullin Ballkanik kundër pushtuesve osmanë. Edhe kuvendet ndërshqiptare dhe ndërballkanike ishin një forcë e rezistencës kundër osmanëve.

Me 8 shtator të vitit 1614 u mblodh Kuvendi i Dytë në Kuç, në Shqipërinë e Epërme ku morën pjesë: patriarku i Serbisë, krerët nga të gjitha krahinat e Shqipërisë së Epërme, Bosnja, Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Bullgaria dhe nga pjesa e Dalmacisë që ishte nën sundimin osman. Në kuvend u bisedua që edhe një herë kapedan Gjon Renësi të merrte përsipër të shkonte në Itali, te Shenjtëria e Tij (papa) për të njoftuar për mënyrën se çka ishte vendosur në Kuvendin për çlirimin e popujve të Ballkanit nga sunduesit osman.[28]

---

[27] *Po aty.*

[28] Fransoa Lenormant, *Turcs et Monténégrins*, Paris, Librairie Académique, Didier & Co, Libraires – Éditeurs, 35, Quai des Augustins, 1866, Tous droits reserves, f. 331; Fransoa Lenormant, *Turci i Crnogorci*..., f. 295.

Fillimisht krerët dëshironin të shihnin duke sjellë sa më shumë armë në malësitë shqiptare – malazeze dhe në malet e Himarës, afër detit. Kjo do të ishte e lehtë pasi osmanët nuk mund të futeshin aty asnjëherë, dhe ata as që i kishin paguar ndonjëherë taksa Sulltanit dhe kishin qenë kështu çdo herë të lirë. Pastaj nga malësitë do t'ua përcjellin këto armë dukagjinasve të cilët ishin afër, kurse prej andej do t'ua shpërndanin malësorëve të tjerë që bëjnë pjesë në këtë marrëveshje të fshehtë, siç janë Pipri, Kelmendi, Kuçi, Vershevo dhe Palabardhi (Bjelopavliqi), të cilët ishin të lirë për tridhjetë vjet dhe nuk i paguanin taksat sulltanit. Nga armatosja e kësaj pjese të malësisë mund të dilnin deri 30.000 ushtarë të mirë. Krahas kësaj ishte vendosur të silleshin 12.000 ushtarë nga krahinat që kishin bërë marrëveshjen e fshehtë jashtë këtyre malësive siç janë Serbia, Hercegovina, Maqedonia, Shqipëria dhe Bosnja. Kështu që ushtria do të arrinte në 42.000 ushtarë, të gjithë të përgatitur fizikisht dhe të zgjuar, nga të cilët 12.000 do të ishin kalorës dhe 30.000 këmbësorë.[29]

Pas urdhrit që do të jepej do të veprohej në atë mënyrë që himarjotët do të dilnin me 8300 burra, do të niseshin menjëherë mbi Vlorë, që ta merrnin në befasi kështjellën dhe qytetin gjë që mendohej e lehtë, sepse roja e kështjellës dominohej nga të krishterët dhe disa nga ata ishin në marrëveshje me himarjotët e lartpërmendur.[30] Ata të Dukagjinit me një pjesë tjetër do të drejtoheshin për në Krujë për ta shtënë në dorë, dhe kjo do të kryhej pa asnjë pengesë, sepse një pjesë e murit pranë dyerve të kështjellës ishte rrënua kurse osmanët nuk e kishin meremetuar fare atë pjesë të murit. Pjesa tjetër do t'i drejtohej Shkodrës, sepse hezitonte një marrëveshje me ata që janë në kështjellë, dhe pjesa tjetër do të shkonte nga Kastelnovo, por përpara kësaj malazezët do të kishin në dispozicion një natë për t'u futur në kështjellë, pasi ekzistonte një marrëveshje me të krishterët që ruanin natën.

---

[29] *AQSH,* F. 846, Viti ???, D. 76, Dy Kuvendet e Kuçit; *AIH*, P-44, "Mbledhja e marrëveshje e krerëve serbë në Kuç ..."; Stefanaq Pollo, Arben Puto, Kristo Frashëri, Skënder Anamali, *Histoire de L'Albanie, des origjinës à nos jours,* Préface de Maurice Baumont, de I'Institut, Editions Harvath, Roanne, Horvath, 1974, f.105.

[30] Injac Zamputi, Stavri Naçi, Zija Shkodra, *Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, Shqipëria nënsundimin feudal-ushtarak otoman (1506-1839),* vëll. III, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë, 1961, dok. (66): "Plani i kryengritjes paraqitë nga Kuvendi i Kuçit Karlit të II-të Kazaga, duka i Nevers", f. 121; F. Lenormant, *Turcs et Monténégrins…,* f.332.

Sapo të kryhej sulmi nga këto malësi do të ngriheshin viset e lartpërmendura pjesëmarrëse të marrëveshjes së fshehtë dhe do të vritnin të gjithë ushtarët osmanë që do të gjendeshin atje. Dhe kjo nuk do të ishte e vështirë, sepse ndaj dhjetë trupave osmane qëndronin 200 të krishterë. Pastaj, një pjesë e popujve do të drejtohej drejt Shkupit dhe aty do të bashkoheshin me ta 42.000 burrat e përmendur me lart, që numri i luftëtarëve të arrinte në 120.000 ushtarë të përgatitur dhe të zgjuar. Sipas parashikimeve organizimi i kësaj ushtrie do të kryhej brenda dy muajve.[31]

Dhe, një pjesë e tyre do drejtohej për Edrene (Adrianopojë) me ndihmën e viseve të lartpërmendura që bënin pjesë në marrëveshjen e fshehtë, dhe përpara se të arrihej në Adrianopojë do të arrinin numrin 160.000 luftëtarë, madje edhe më shumë në qoftë se do të ishte nevoja. Edhe ky marsh do të kryhej pa kurrfarë pengesa nga ana e armikut sepse kryengritja kishte për të filluar në muajin tetor kur osmanët janë të çarmatosur. Pra, "mbasi osmanët në atë kohë në Evropë nuk kanë ushtri, e cila do të ndeshej me tonën, do t'u duhej ta sjellin nga Azia.[32] Por, kjo nuk do të jetë e mundur, ushtria osmanepara gjashtë muajsh nuk do të mund të afrohej. Dhe me qenë se te osmanet ishte akoma zakon që ushtrinë e nisin në luftë vetëm pas korrjeve ne do të kemi tetë muaj në dispozicion që të furnizohemi me të gjitha gjërat e nevojshme. Dhe kur të ngrihen në kryengritje të gjitha këto krahina osmanët do të jenë shumë të dobët krahas kësaj që do na vijnë në ndihmë dhe sundimtarët katolik rreth e rrotull tokat e të cilëve kufizohen me Bullgarinë dhe këta janë princat e Vllahisë e Moldavisë. Mbasi me ta janë bërë marrëveshje nëpërmjet argjipeshkvit të Vllahisë i cili është kushëriri i patriarkut të Serbisë, dhe për këtë arsye do të vijnë me gjithë qejf sepse do të mbesin përgjithmonë princa ata dhe pasardhësit e tyre.[33]

Në një periudhë prej tetë muajsh shpresojmë që me ndihmën e zotit do të futemi në Kostandinopojë pasi që duket një ndërmarrje e kollajshme sepse në rrugë nuk ka kurrfarë kështjelle që të humbet kohë rreth pushtimit të saj dhe as për të na penguar rrugën tonë.[34] Të tilla ka vetëm në kufij me Hungarinë e Kroacinë të cilat do t'i lemë pas dhe me

---

[31] F. Lenormant, *Turcs et Monténégrins…,* f.332; *Dokumente të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë ...,* vëll. III, dok. (189): "1614 shtator 8 – Projekt i luftës për çlirimin e Ballkanit i dalë nga Kuvend i Kuçit në Shqipëri Veriore", f. 303.

[32] *AQSH,* F. 846, D. 76, Dy Kuvendet e Kuçit.

[33] *AIH*, P-44, "Mbledhja e marrëveshje e krerëve serbë në Kuç ...".

[34] *AQSH*, F. 846, D. 76, Dy Kuvendet e Kuçit ....

këtë rast perandori nuk do të vonojë për të pushtuar Hungarinë dhe as arkiduka Kroacinë”.[35]

Në kuvend në rast të kësaj kryengritjeje duhet të priten monedha me vlerë të vogël pak të larë me serm, dhe të shpallet që të gjithë popujt ta pranojnë nga ushtarët kur të paguajnë ushqimin. Dhe kështu do ta ketë në çdo tre muaj duhet t’ua sjelli ministrive të këtyre krahinave për çka atyre do t’u jepet një shumë e mirë të hollash, kjo do të bëhet që ushtarët të paguhen çdo muaj dhe të mos bëhen barrë në kurriz të popullit. U vendos që edhe gjithë plaçka që do t’u merrej gjatë plaçkitjeve të qyteteve siç është ari, stolitë e argjendi do t’i dorëzoheshin arkës dhe për mbajtjen e ushtrisë. Kurse nga këto do të bëhej një pasuri kaq e madhe sa për disa vite do të mund të bëhet luftë pa ndihmën e askujt. Kur të jetë marrë Kostandinopoja do të hiqej edhe monedha e mësipërme dhe secili do të kënaqej dhe do t’i jepej secilit monedhën e mirë.[36]

Shtytje të madhe projekteve ballkanike dhe evropiane për dëbimin e Perandorisë Osmane nga Ballkani i kanë dhënë Kuvendet shqiptare dhe ato ndërballkanike. Projektet e dala nga kuvendet dhe lufta e shqiptarëve gjatë shek. XVI dhe XVII, vunë në lëvizje popullin shqiptar, që në vazhdimësi qëndroi në vëmendjen e shteteve evropiane. Shqiptarët i zgjeruan përtej kufijve të saj projektet çlirimtare, ku vunë në lëvizje edhe popujt e tjerë të Ballkanit, dhe zunë vend të rëndësishëm në kuvendet e përbashkëta me malazezët, hercegovinasit, boshnjakët, serbët dhe bullgarët.

---

[35] I. Zamputi, S. Naçi, Z. Shkodra, *Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë ...,* vëll. III, f. 121; *Dokumente të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë ...,* vëll. III, dok. (66): "Plani i kryengritjes paraqitë nga Kuvendi i Kuçit Karlit të II-të Kazaga, duka i Nevers", f..., 122.

[36] *AIH*, P-44, Mbledhja e marrëveshje e krerëve serbë në Kuç ....